

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Mentor Bajraktari, me procesmbajtësen Nushe Kadrija – sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit A.J. nga fshati G., Komuna e H.-Republika e Sh., për shkak të veprës penale të vjedhjes nga neni 325 par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP.nr.1431/14, të datës 06.11.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar **me datën 12.07.2018**, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Ismet Tofaj, të dëmtuarit A.S., të akuzuarit si dhe mbrojtëses së tij av.B. K. nga Gjakova, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

A.J.nga i ati Rr., e ëma N., e gjinisë Gj., i lindur me datën Data e Lindjes... në T., tani me vendbanim në fshatin G., Komuna e H.-Republika e Sh., i pa martuar, ka të kryer 4 (katër) vite të shkollës fillore, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Shqipërisë.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datën 20.01.2014, në rrugën “M.” p.n në Gj., me qëllim që vetit apo tjetrit ti sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, me qëllim vjedhje, shkon tek shtëpia e të dëmtuarit A. (N.) S.nga Gj., me banim në rrugën “M.” p.n, ashtu që nga kamioni i markës “M.”, me targa të regjistrimit, i cili ishte i parkuar në oborr heq dhe vjedhë një bateri të llojit “....”, si dhe nga dy kamionët tjerë të parkuar nxjerr dhe vjedhë 100 litra naftë dhe largohet në drejtim të panjohur.

Me këto veprime ka kryer veprën penale të vjedhjes nga neni 325 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par. 1, 41, 42, 43, 45, 46, 73, 74 dhe nenit 325 par.1 të KPRK-së, të akuzuarin e:

G J Y K O N

ME DËNIMIN ME BURGIM në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve, dhe

ME DËNIM ME GJOBË në shumë prej 200 (dyqind) Euro të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguajë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin me gjobën në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, atëherë gjykata të akuzuarit dënimin me gjobë ia zëvendëson me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditëve, ashtu që për çdo ditë të kaluar në burgim do të llogaritet nga 20 (njëzet) Euro.

I dëmtuari: A.(N.) S.i nga Gj., me banim në rrugën “M.i” p.n, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

Detyrohet i akuzuari që ti paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësorë në shumë prej 30 (tridhjetë) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën me numër PP.nr.1431/14, të datës 06.11.2015, kundër të akuzuarit A. J. nga fshati G., Komuna e H.-Republika e Sh., për shkak të veprës penale të vjedhjes nga neni 325 par.1 të KPRK-së. Prokurori i shtetit Ismet Tofaj, gjatë shqyrtimit fillestar ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarit A. J., andaj ka propozuar që i njëjti të shpallët fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari A.J., gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se: pas konsultimeve të mjaftueshëm me mbrojtësin time av.B. K., e pranojë fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohem dhe ka shtuar se është penduar për këtë veprim dhe gjykatës i ka premtuar që në të ardhmen nuk do të përsëris veprime të këtilla.

Prokurori i shtetit Ismet Tofaj, duke dhënë mendim rreth pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se: nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ngase pranimin e fajësisë i akuzuari e bëri në mënyrë vullnetare pa presion, i vetëdijshëm për natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe se pranimi i fajësisë ka mbështetje edhe në provat materiale që gjendjen në shkresat e lëndës.

I dëmtuari A.S., duke dhënë mendim rreth pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se: nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, si palë e dëmtuar parashtroi kërkesë pasurore-juridike të cilën do ta realizoi në kontest juridiko-civil.

Mbrojtësja e të akuzuarit A. J. av.B. K., duke dhënë mendim rreth pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se: i mbrojturi imë A. J. i cili akuzohet sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë për veprën penale vjedhje nga neni 325 par.1 të KPRK-së, pasi që ia kam shpjeguar të gjitha pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë, i njëjti e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën ngarkohet me vullnet të plotë dhe pa asnjë lloj presioni andaj kërkojë që gjatë matjes së dënimit, pranimi i fajësisë të merret si rrethanë lehtësuese që është edhe benifit ligjor me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit andaj edhe kërkojë që të aprovohet pranimi i fajësisë.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi është vërtetuar se i akuzuari A. J., me datën 20.01.2014, në rrugën “M.” p.n në Gj., me qëllim që vetit apo tjetrit ti sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, me qëllim vjedhje, shkon tek shtëpia e të dëmtuarit A.(N.) S., nga Gj., me banim në rrugën “M.” p.n, ashtu që nga kamioni i markës “M.”, me targa të regjistrimit, i cili ishte i parkuar në oborr heq dhe vjedhë një bateri të llojit “.... A”, si dhe nga dy kamionët tjerë të parkuar nxjerr dhe vjedhë 100 litra naftë dhe largohet në drejtim të panjohur.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësen e tij av.B. K., pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e paraparë në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të vjedhje nga neni 325 par.1 të KPRK-së dhe për

këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpall fajtor dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: i pa punë, i gjendje së dobët ekonomike, është mbajtës i familjes prej 7 (shtatë) anëtarësh, nuk ka punë të rregullt, në gjykim ka pas qëndrim tejet korrekt, pendimin e tij dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale. Ndërsa si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestarë nga ana e të akuzuarit për veprën penale për të cilën ngarkohet. Ndërsa si rrethana rënduese gjykata ka vlerësuar faktin se i akuzuari ka qenë i dënuar edhe më parë për vepra penale të natyrës së njëjtë për të cilat edhe tani është në vuajtje të dënimit. Kështu që duke mos gjetur rrethana tjera rënduese për të akuzuarin, gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimet e shqiptuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 41 i KPRK-së dhe këto dënime si të tilla të shqiptuara sipas bindjes së gjykatës janë në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 463 par.2 lidhur me par.1 të KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësorë është marrë konform nenit 450 par.2 pika 2.6 në lidhje me nenin 453 par.1 të KPP-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti i përgjithshëm –
P.nr.704/15, me datë 12.07.2018

Procesmbajtësja,
Nushe Kadrija

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Mentor Bajraktari

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.